

RELACION

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), DHE AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “POLITIKA PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS NË SEKTORIN ENERGETIK NË SHQIPËRI”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep mundësi Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë, për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri.

Projektligji është në përputhje me angazhimet e memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunimin financiar ndërmjet Shqipërisë, Francës dhe Gjermanisë lidhur me programin “Mbështetja e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, nënshkruar në vitin 2018.

Projektligji është vazhdimi i angazhimit të qeverisë shqiptare për të finalizuar reformimin e të gjithë sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri, duke plotësuar angazhimin ndërkombëtar të tyre lidhur me këtë reformim, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, konsolidimin e ndarjes së OSHEE-së – Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës së Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikat e Këshillit të Ministrave për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik, duke synuar përmirësimin e sektorit

energjetik të Shqipërisë, nëpërmjet reformës që shtrihet në drejtime të shumëfishta: strukturore, operacionale dhe financiare.

Projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të akteve për vitin 2021, por, nisur nga rëndësia që paraqet ky financim për zhvillimin e reformave në sektorin energjetik, e konsiderojmë të domosdoshëm miratimin sa më shpejt të tij.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji i mundëson Republikës së Shqipërisë marrjen e një huaje me kushte të favorshme nga Agjencia Franceze për Zhvillim (në vijim, AFD), për programin “Mbështetja e reformës së sektorit energjetik të Shqipërisë”, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro.

Qëllimi i dhënies së huas është që të financojë në buxhetin e huamarrësit dhe të mbështesë realizimin e plotë të programit sipas aneksit 2 – përshkrimi i programit, në përputhje me aneksin 3A- Plani i financimit dhe kartës monitoruese të përshkruar në aneksin 3B - Skema monitoruese.

Referuar memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, *KfW* dhe AFD-së, të datës 14.12.2018, dhe vendimit nr.742, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po implementon planin strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri. Ky plan strategjik përmban një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Evropian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm, duke drejtuar reformën e sektorit të energjisë në përputhje me udhërrëfyesin (*roadmap*), miratuar në vitin 2018, që parashikon plotësimin me sukses të 11 elementeve të reformës në fundvitin 2020 dhe vazhdimin e 7 elementeve të tjera në fundvitin 2021.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i ndarjes së OSHEE-së - Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës të Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AFD-ja dhe *KfW*-ja, bazuar në memorandumimin e mirëkuptimit, po implementojnë planin strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri. Ky plan strategjik ka vizionin e tij, zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë, që çon në një sistem rajonal të integruar e të

diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale. Ky plan strategjik përmban një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar sipas modelit të Bashkimit Evropian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 81, pika 1, 83, pika 2, e 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja kuadër e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.518, datë 18.9.2021, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe AFD-së, për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik - faza 1, me një kredi në shumën 50 000 000 euro, është i lidhur me plotësimin e 11 elementeve të reformës së energjisë në nivel të kënaqshëm, siç janë parashikuar në aneksin 2.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e aktit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Marrëveshja e huas, që propozohet të miratohet në parim nëpërmjet këtij projektligji, ka termat financiarë të mëposhtëm:

Shuma:	50,000,000 euro;
Interesi:	euribor 6-mujor + 1.35%;
Komision angazhimi:	0,25 % në vit;
Afati i ripagimit:	12 vjet;
Periudhë pa pagesë principali:	3 vjet;
Tarifë menaxhimi:	0.75%

Zbatimi i këtij projekti në këtë fazë nuk do të ketë efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE